

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Orientalistikë
Titulli i lëndës:	Hyrje në letërsinë perse
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	IV
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Filologjisë/ UP Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Abdullah hamiti
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:abdullahamiti@yahoo.com">abdullahamiti@yahoo.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Lënda <i>Hyrje në letërsinë perse</i> ofron një pasqyrë të shkurtë të historisë së letërsisë perse. Fillimisht bëhet periodizimi i letërsisë perse duke u mbështetur në faktorët gjeografik e historiko-politik. Letërsia e Iranit të lashtë – paraislame. Islamizimi i persëve. Iranasit si prijës të renesancës shkencore në shekujt e parë të Islamit dhe lindja e letërsisë paraklasike perse. Stili letrar i Horasanit. Me këtë cikël studentët njoftohen me paraqitjen e poetëve të parë të mëdhenj të poezisë klasike perse, si: Rudaki, Firdevsi, Dekiki. Pastaj studentët njoftohen me stilin letrar të Irakut, që është periudha më e rëndësishme e letërsisë perse. Duke i përmendur autorët eminent si: Senai, Attari, Omer Hajami, Mevlana Xhelaluddin Rumi, Sadi Shirazi, Hafiz Shirazi, Abdurrahman Xhami studentët duhet të mësojnë për karakteristikat që ata i bëjnë të veçantë, të cilët edhe sot në mënyrë aktive studiohen anë e mban botës dhe, perse krijimtaria e tyre edhe më tutje është majft aktuale. Në ciklin e fundit, studentët do të njoftohen edhe me rrjedhën e letërsisë bashkëkohore perse duke u përqëndruar në rrjedhat kryesore dhe tek autorët më të dalluar të poezisë dhe prozës bashkëkohore perse.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Ky kurs ka për qëllim që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- t'u ofrojë studentëve njohuri për rrjedhën e zhvillimit të letërsisë perse.</li> <li>- të nxënë njohuritë për shkollat klasike letrare që e karakterizojnë zhvillimin e letërsisë perse.</li> <li>- të nxënë njohuri të duhura për klasikët e mëdhenj të letërsisë perse si Firdevsi, Rumi, Hajami, Hafizi etj.</li> <li>- të njoftohen me rrjedhën e letërsisë bashkëkohore</li> </ul>

	perse.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- t'ë përshkruaj periodizimin e letërsisë perse.</li> <li>- të diskutojë për ndryshimin stilistik, tematik dhe përmbajtësor të shkollave letrare të Horasanit dhe të Irakut.</li> <li>- të identifikojë klasikët e mëdhenj pers dhe rolin e tyre në letërsinë klasike botërore.</li> <li>- të prezantojë rezultatet e letërsisë bashkëkohore perse.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare			
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Mësimi është mësim i rregullt me formën e ligjeratave 2 orë në javë dhe poashtu përcillet me punë praktike gjatë ushtrimeve 2 orë në javë. Ushtrimet me studentë ku do të ketë diskutime e dialogje dhe përkthime nga krijimtaria letrare perse zhvillohen në grup e pastaj kalohet edhe në punë individuale që do të bëhet kryesisht jashtë ambienteve të fakultetit (shtëpi, bibliotekë)..</p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Do të zbatohen këto metoda të vlerësimit:</p> <p>Vlerësimi i parë: 15%</p> <p>Vlerësimi i dytë: 15%</p> <p>Angazhimet e tjera 15%</p> <p>Vijimi i rregullt 5%</p> <p>Provimi final: 50%</p>		

	Totali	100%
<b>Literatura</b>		
<b>Literatura bazë:</b>	Ahmed Tamimdari, Historia e letërsisë perse, Tiranë, 2008; Becir Dzaka, Historija persijske knjizevnosti – od nastanka do kraja 15. Vijeka-, Naucnoistrazivacki institute “Ibn Sina”, Sarajevo, 1997.	
<b>Literatura shitesë:</b>	<i>Dr. Seyed Ali Asghari, ..., Fjalor Persisht – Shqip, Fondacioni Shirazi, Tiranë, 2010</i>	
<b>Plani i dizejnuar i mësimit:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>	
<b>Java e parë:</b>	Periodizimi i letërsisë perse - pasqyrë përmbledhëse e histories së letërsisë perse.	
<b>Java e dytë:</b>	Letërsia e Iranit të lashtë - Periudha paraislame	
<b>Java e tretë:</b>	Islamizimi I persëve. Iranasit si prijës të renesancës shkencore në shekujt e pare të Islamit dhe lindja e letërsisë paraklasike perse.	
<b>Java e katërt:</b>	Llojet letrare dhe poetika islame në poezinë perse	
<b>Java e pestë:</b>	Shkollat klasike letrare që e karakterizojnë zhvillimin e letërsisë perse. Shkolla e Horasanit dhe shkolla e Irakut	
<b>Java e gjashtë:</b>	Ndryshimi stilistik, tematik dhe përmbajtësor midis shkollave letrare të Horasanit dhe të Irakut.	
<b>Java e shtatë:</b>	Vlerësimi i parë intermediar.	
<b>Java e tetë:</b>	Përfaqësuesit e pare të mëdhenj të shkollës së Horasanit: Rudaki Firdevsi, Dekiki.	
<b>Java e nëntë:</b>	Klasikët e mëdhenj të letërsisë perse: Senai, Attari, Omer Hajami, Mevlana Xhelaluddin Rumi, Sadiu Hafiz Shirazi, Abdurrahman Xhami.	
<b>Java e dhjetë:</b>	Poemat moralo didaktike të Feriduddin Attarit.	
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Poezia moralo-filozofike e Mevlana Xhelaluddin Rumiut.	
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Rubairat Omer Hajamit	
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Divani i Hafizit dhe ndikimi i tij në evropë	
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore perse	
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Testi provues përfundimtarë	
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>		
<b>Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.</b>		
Vijimi në ligjërata dhe ushtrime duhet të jetë i rregullt, gjatë mbajtjes së mësimit duhet të mbretërojë qetësia, të shkyçen telefonat celular si dhe hyrja në sallë duhet të jetë me kohë. Plagjiazmi dhe kopjimi në provime janë të dënueshme; studenti merr note negative.		